




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

07 Nr. 104/02-14384/26
Kaçanik, 15.06.2026

Lënda: NJOFTIM

Përmes kësaj shkrese zyrtare, ju njoftojmë se duke filluar nga 16.06.2026 (e marte) do të nisim punimet për shtrimin e rrugës "Qamil Ilazi", përkatësisht prej shtëpisë së mallrave deri te hyrja e objektit komunal.

Për shkak të këtyre punimeve, ju lutemi që të gjithë qytetarëve që kanë veturat e tyre të parkuara në këtë pjesë, t'i largojnë ato gjatë zhvillimit të punimeve.

Gjithashtu, kërkojmë nga të gjithë qytetarët e tjerë që të mos i parkojnë veturat e tyre në këtë segment rrugor gjatë orarit të punimeve, në mënyrë që të mundësohet zhvillimi i tyre pa pengesa dhe të shmanget dëmtimi i mundshëm i automjeteve.

Obligohet kompania e kontraktuar për implementim të projektit, të merr të gjitha masat e duhura me qëllim të rregullimit të komunikacionit, njëkohësisht edhe zhvillimit normal të punimeve.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

Të njoftohen:

1. Policia e Kosovës;
2. Inspektorati komunal;
3. "Elmaz Mezraja B.I";
4. Arkiva

